



Pranuar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Delivered	23.12.2020	viti god year	0
Organ / Njesia Org./Unit	No. Prot. Pr. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMBIK	3275	2020	114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A Nr. 373/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 373/2020 të datës 25.11.2020, të parashtruar nga ankuesja [REDACTED] me adresë banimi rruga „ Hamdi Grajqevci“, lagja Eliza hyrja 5, 3/4, Komuna e Fushë Kosovës, kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “ kontestim konkursi ”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 23.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A. Nr.373/2020 e datës 25.11.2020, e parashtruar nga ankuesja [REDACTED].

A r s y e t i m

Ankuesja [REDACTED], kandidate në konkursin e shpallur nga Komuna e Prishtinës, me datë 02.07.2020, për pozitën e punës „Zyrtar i Pasurisë“, e pakënaqur me njoftimin e Komunës së Prishtinës të datës 13.10.2020, si dhe Vendimin NR.14-07/01-203815/20, të datës 16.11.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës (i pranuar nga ankuesja me datë 18.11.2020), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me datë 25.11.2020 Nr. Protokolli 2751/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.11.2020, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa me datë 11.12.2020, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me provat.

Kolegji për vërtetimit e drejtë dhe plotë të gjendjes faktike si dhe vendosje meritorë të çështjes ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 373/2020, e datës 25.11.2020, me numër protokollit 2751/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 23.10.2020; Ankesën e datës 03.11.2020, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin e datës 18.11.2020, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Njoftimin e datës 13.10.2020; Konkursin e datës 02.07.2020; Vendimin e datës 27.07.2020, për Themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Autorizimin e datës 26.06.2020, të Ministrisë së Administratës Publike; Renditjen Përfundimtare të Kandidateve; Përmbledhja e Vlerësimeve Individuale; Vlerësimin individual të kandidateve Armend Kozhani dhe ankueses, për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhë të huaj; testin me shkrim; Kërkesën për punësim të [REDAKTUAR], certifikatën e datës 14.01.2020; Diplomë e datës 14.03.2016; dëshmi nga trusti për [REDAKTUAR]; Kërkesa për punësim të Arbnore Kaliqani, me shkresë të bashkangjitura, Certifikatë e datës 10.07.2020; Diplomë e datës 01.03.2019; Dëshmi nga trusti; Raporti Final i Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues; Përgjigje në ankesës e datës 11.12.2020, me numër protokollit 3096/2020, me shkresat e bashkangjitura si dhe njoftimi i datës 04.12.2020.

Kolegji për shqyrtim dhe vendosje të ankesës, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa është e pabazuar, sepse:

Kolegji konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet për shqyrtimin e ankesës në kuptim të pranueshmerisë së saj, ashtu siç kërkohet me nenin 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtim dhe Vendosje të Ankesave, ka shtjelluar pretendimet ankimore të ankueses, e cila pretendon se: Komisioni Përzgjedhës për pozitën "Zyrtar i Pasurisë", nuk ka vepruar sipas nenit 41.4 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil, ku rezultatet duhet të shpallen brenda 7 ditësh pas përfundimit të procedurës (intervistës më gojë), konkursi është shpallur dhe të gjitha procedurat janë ndjekur bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil, kështu që edhe procedura e ankesës është dashur që të vazhdojnë sipas Ligjit për Shërbimin Civil, e jo Komisioni i Ankesave të shpallet jo kompetent sipas ligjit të ri Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe se ankuesja

Nga shkresat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Komuna e Prishtinës, pas autorizimit të datës 26.06.2020 të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil, me datë 02.07.2020 ka shpallur konkursin për pozitën "Zyrtar i Pasurisë", në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja.

Për pozitën e shpallur "Zyrtar i Pasurisë", në Komunën e Prishtinës, kritere kryesore të konkursit kanë qenë: *Diplome Universitare; drejtimi ekonomik, juridik, dhe Administratë Publike, minimumi dy (2) vite përvojë pune profesionale.*

Kolegji nga analizimi dhe administrimi i shkresave të parashtruara nga palët, vlerëson se lista e shkurtër për këtë pozitë është përgatitur brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 26 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, po ashtu procedura e

themelimit të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil, testimi me shkrim dhe testimi me gojë janë zhvilluar në pajtim me nenin 7, 36 dhe 38 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Lidhur me pretendimin ankimor se ka pasur tejkalim të afatit prej shtatë(7) ditësh për publikim të rezultateve përfundimtare ashtu siç parashihet me nenin 41 paragrafi 4 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtim dhe Vendosje të Ankesave ka konstatuar se ky pretendim është i pabazuar, sepse rezultati përfundimtar është publikuar brenda afatit të përcaktuar me nenin 41 paragrafi 4 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ku thuhet " *rezultatet publikohen brenda 7 ditësh pas përfundimit të procedurës së rekrutimit dhe vendimit për emërim të kandidatëve të suksesshëm*" përkatësisht Raporti Përfundimtar i Komisionit Përzgjedhës për pozitën " Zyrtar i Pasurisë", si akt përmyllës i procesit të rekrutimit është bërë me datë 07.10.2020, ndërsa publikimi i rezultateve është bërë me datë 13.10.2020, e që nënkupton respektimin e afatit ligjor në fjalë.

Po ashtu, Kolegji ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur [REDAKTUAR] për pozitën "Zyrtar i Pasurisë", ka plotësuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas konkursit të datës 02.07.2020, përkatësisht Kolegji ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur Armend Kozhani në bazë të Certifikatës së datës 23.07.2013 ka të kryer Fakultetin Ekomomik, Bachelor, drejtimi për Banka, Financa dhe Kontabilitet në Universitetin e Prishtinës " Hasan Prishtina", në bazë të diplomës së datës 14.03.2016 ka të kryer Master për Banka, Financa dhe Kontabilitet, dhe sipas Pasqyrës së TRUST-it ka përvojë pune nga data 16.06.2016 deri në momentin e aplikimit për këtë pozitë. Andaj, Kolegji vlerëson se Komuna e Prishtinës ka vepruar në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: "*Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitete dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës*".

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankueses, se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, i Komunës së Prishtinës, është dashur që të shqyrtoj ankesën e ankueses sipas nenit 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është i pabazuar faktin se dispozita në fjalë i referohet zyrtarëve të shërbimit publikë e jo zyrtarëve të shërbimit civil dhe se me nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është përcaktuar "*Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimi në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative. Në kuptim të kësaj baze ligjore, rrjedhë se pretendimi i ankueses është i pabazuar.*

Po ashtu ndërlidhur me Vendimin Nr. 14-07/01-203815/20 të datës 16.11.2020 të Komisionit Për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, kolegji gjënë se është dhënë udhëzim i gabuar juridik lidhur me të drejtën e ankesës, ndërsa në arsyetim të vendimit janë dhënë sqarime ashtu siç parashihet me nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.



Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga kryetarja e Kolegjit për shqyrtim dhe Vendosje të kësaj ankese.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda Nr. A. Nr. 373/2020

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj - DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së